Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/186
Datë: 13.07.2015

Në mbështetje të neneve 15, pika 2, dhe nenit 17, pikat 1.5, 1.6 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 9, 12, 13, 14, 15, dhe 18, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 13. 07. 2015 nxjerr këtë:

Vendim

1. Miratohen aplikacionet për rivalidim të kualifikimeve dhe riakreditim për profilet dhe institucionet në vijim:
    - QRAP Ferizaj, me profilet TIK niveli II i KKK; Saldim niveli III i KKK; Instalues elektrik niveli III; Instalues i ujesjellsit dhe kanalizimit niveli III.
    - QRAP Prishtinë, me profilet TIK niveli II i KKK; dhe Asistent Administrativ niveli II i KKK;
    - QRAP Gjakovë me profilet Saldues niveli III i KKK; Asistent Administrativ niveli III i KKK, Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla (Themelues i Biznesit) niveli III i KKK.
    - QRAP Prizren me profilet TIK niveli II i KKK; dhe Saldim niveli III i KKK.
    - QRAP Gjilan me profilet TIK niveli II i KKK; dhe Saldim niveli III i KKK.
    - QRAP Pejë me profilet Asisitent Administrativ niveli III i KKK; Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit niveli III i KKK; dhe Instalues elektrik niveli III i KKK;
    - QRAP Mitrovica me profilet Saldues niveli III dhe me TIK niveli II;
    - Don Bosko me profilet Asistent Administrativ niveli III i KKK; TIK niveli II dhe niveli IV i KKK; Saldues niveli III i KKK; Instalues elektrik niveli III i KKK; Instalues i ngrohjes Qendrore niveli III i KKK; dhe Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit niveli III i KKK.
    - Britannica me dy qendra për gjuhe angleze;
    - London Eye për gjuhe angleze.

2. Miratohet aplikacioni për validim të kualifikimit dhe akreditim për profilin dhe institucionin:
    - QRAP Ferizaj me profilin Instalues i Ngrohjes Qendrore.

3. Autoriteti Kombëtar u Kualifikimeve është i obliguar që t'i njoftojë të gjitha institucionet aplikuese për rivalidim të kualifikimeve dhe riakreditim si dhe institucionin aplikues për validim të kualifikimit dhe akreditim, të krijojë panelet e ekspertëve dhe te vazhdojë procesin sipas legjislacionit në fuqi.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet të gjitha palëve të interesit.

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani